



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 29.10.2025
Numër Protokolli: 7044/2025

A.nr.1599/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.1599/2025, të datës 15.08.2025, të parashtruar nga ankuesi B.D, nga Vushtrria, kundër organit të punësimit: Komunës së Vushtrrisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1599/2025, e datës 15.08.2025, e parashtruar nga ankuesi B.D.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 29525/25, i datës 30.06.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Komunës së Vushtrrisë për refuzimin e aplikacionit të ankuesit dhe Njoftimi me numër protokolli 35741/25, i datës 24.07.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Komunës së Vushtrrisë për shpalljen e rezultatit përfundimtar, lidhur me konkursin me Nr.Reference RN00017867 për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Financave dhe Kontabilitetit.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, B.D (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 14.08.2025, përmes emailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ndërsa është regjistruar më datë 15.08.2025 nën shenjë A.nr.1599/2025, kundër refuzimit të aplikacionit lidhur me konkursin me Nr.Reference RN00017867 për klasën e pozitës Drejtues i Ulët vendi i punës Udhëheqës i Sektorit të Financave dhe Kontabilitetit i shpallur nga Komuna e Vushtrrisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 10.08.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Vushtrrisë, ndërsa kjo e fundit me datë 23.08.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 22.09.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:6295/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1599/2025 të datës 15.08.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) si prova i administroi: Ankesën me numër protokolli 5506/2025 të datës 15.08.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:6295/2025; Njoftimin nga SIMBNJ; Kopjen e ID-së së ankuesit; Certifikatat e ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.08.2025; Kërkesën për hapje të konkursit së bashku me konkursin me numër të protokollit 19228/25; Përgjigjen në ankesë e datës 23.08.2025; Konkursin me Nr. Reference RN00017867, për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit të Financave dhe Kontabilitetit; Njoftim për verifikim paraprak datë 30.06.2025; Vendimi me numër të protokollit për 2952/25 i datës 30.06.2025 për refuzim të aplikacionit; Vendimi për formimin e komisionit të pranimit, me numër të protokollit 31346/25 i datës 07.07.2025; Akt emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit; Lista-Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 24.07.2025; Njoftimin me numër protokolli 35741/25 të datës 24.07.2025 për rezultatet përfundimtare dhe kandidatin fitues; Njoftimi me numër të protokollit 24990/25 i datës 22.07.2025 lidhur me kandidatet që e kanë kaluar testimin me shkrim; Njoftimi për testim elektronik me shkrim me numër të protokollit 31604/25 i datës 08.07.2025; Kërkesa për caktimin e orarit të testimit me shkrim nga z. J. S; Përgjigja nga znj. S.Gj lidhur me caktimin e orarit për testim me shkrim; Njoftimi për testim elektronik me shkrim drejtuar kandidateve; Aplikacioni i znj. L.H. prej 24 faqe; Aplikacioni i z. B.D prej 40 faqe.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Komuna e Vushtrrisë, më datë 19.05.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017867, për klasën e pozitës Drejtues i Ulët vendi i punës *Udhëheqës i Sektorit të Financave dhe Kontabilitetit*, me afat aplikimi nga data 20.05.2025 deri më datë 18.06.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar 11 kandidatë, ndërsa sipas njoftimit të datës 30.06.2025, në fazën e verifikimit paraprak janë përfshirë katër (4) kandidatë, ndërsa sipas Vendimit me numër të protokollit 29525/25 të datës 30.06.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë, ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se në aplikacionin e tij i mungon diploma e arsimit të kërkuar sipas konkursit, duke konstatuar se ka të përfunduar arsimimin e lartë e nivelit të parë (bachelor) drejtimin “Bachelor i Gjeologjisë”.

Pas përfundimit të procedurës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrrisë më datë 24.07.2025, ka publikuar Njoftimin me numër të protokollit 35741/25 për rezultatet përfundimtare të vlerësimit me dy kandidat fitues: Lindita Haradinaj me gjithsej 90.2 pikë dhe Xhafer Islami me 77.2 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se refuzimi i aplikacionit është i padrejtë për shkak që ankuesi pretendon se ka kualifikimin adekuat sipas kërkesave të konkursit, duke poseduar diplomë të studimeve master në degën e menaxhmentit për ekonomi dhe pretendon se ka përvojën e punës. Kërkon që ankesa të aprovohet dhe të obligohet institucioni të anulohet procedura e rekrutimit dhe të kthehet procedura në verifikim paraprak.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar aktin e shpalljes së kësaj pozite, respektivisht sipas konkursit me Nr. Reference: Nr. Reference: RN00017867, për klasën e pozitës Drejtues i ulët vendi i punës *Udhëheqës i Sektorit të Financave dhe Kontabilitetit* i shpallur nga Komuna e Vushtrrisë dhe ka konstatuar se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Ekonomik, Financa dhe Kontabilitet. Përvoja e punës së kërkuar:* *Se paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*

Rrjedhimisht, Kolegji lidhur me këtë çështje juridike, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht: Nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërin nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj",*

- Nenit 39 paragrafi 1, dhe 7, ku përcaktohet: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.*

Po ashtu Kolegji i Këshillit ju referua, Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, respektivisht nenit 7 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit.*

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit i cili pretendon se ka kualifikimin adekuat sipas kërkesave të konkursit duke pretenduar se posedon diplomë të studimeve master në degën e menaxhmentit për ekonomi, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se sipas Vendimit me numër protokolli 29525/25 të datës 30.06.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë, ankuesit i është refuzuar aplikacionin për shkak se në aplikacionin e tij i mungon diploma e arsimit të lartë e

nivelit të parë (Bachelor) si kërkesë e konkursit, e me qëllim të vlerësimit të drejtë të kësaj çështje, Kolegji ka shqyrtuar aplikacionin e ankuesit të datës 02.06.2025, dhe ka konstatuar se ankuesi posedon diplomën e nivelit themelor të studimeve me Nr.389 të datës 06.11.2014 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohet se më datë 01.06.2012 ka përfunduar studimet themelore në Departamentin e Gjeologjisë në Fakultetin e Gjeoshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë, duke marr titullin Bachelor i Gjeologjisë, po ashtu posedon Diplomën me Nr.04/2015 të datës 12.01.2015 të lëshuar nga Kolegji Gjilani me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet Master në Programin Menaxhment. Rrjedhimisht nisur nga kërkesat e përgjithshme formale të konkursit sa i përket arsimit të kërkuar, rezulton fakti i pakontestueshëm që është kërkuar *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Ekonomik, Financa dhe Kontabilitet*, e ku sipas aplikacionit të ankuesit i njëjti nuk e posedon arsimimin e nivelit bachelor të kërkuar sipas konkursit, ndërsa ndërlidhur me pretendimin e tij se posedon diplomë të nivelit master në menaxhimet në ekonomi, Kolegji vë në dukje faktin se për pozita të tilla nuk kërkohet nivel i studimeve master, kjo referuar edhe shtojcës Nr. 1/3 të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil për pozitën e kategorisë së ulët drejtuese përcaktohet *Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor)*. Kështu që Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrrisë me rastin e verifikimit paraprak respektivisht me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 29525/25, të datës 30.06.2025 për refuzimin e aplikacionit të ankuesit, ka vepruar në plotëni me kërkesat e përgjithshme formale të konkursit në pajtim me kompetencat e dhëna sipas nenit 39 paragrafi 7 nën paragrafi 7.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e për rrjedhojë akti për refuzimin e aplikacionit të ankuesit, është akt i drejtë dhe i ligjshëm i nxjerr në pajtim me kërkesat e përgjithshme për praninë të përcaktuar me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe kërkesave të konkursit dhe i arsyetuar, mbi këtë bazë ankuesi nuk ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale gjegjësisht arsimin e kërkuar sipas konkursit.

Duke qenë se ligjshmëria e procedurës së pranimit, shqyrtohet në fazën përfundimtare, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar aplikacionin e kandidatës fituese me më së shumti pikë, me qëllim që të konstatohet fakti nëse e njëjta ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit, dhe si rezultat i kësaj sipas aplikacionit të kandidatës L.H të datës 12.06.2025, rezulton se e njëjta posedon Diplomën me Nr. 191/11 të datës 30.12.2011 të lëshuar nga Kolegji Dardania, me të cilin dëshmohet se më datë 29.12.2011 ka përfunduar studimet e arsimit të lartë të nivelit bachelor në Banka Financa dhe Kontabilitet. Ndërlidhur me përvojën profesionale të punës rezulton se sipas Akt emërimit të datës 16.01.2013 nga kjo datë deri më datë 16.05.2016 ka mbajtur pozitën Zyrtare për Taksa Komunale, sipas akt emërimit të datës 16.05.2016 deri më datë 01.08.2024 ka mbajtur pozitën Zyrtare për Kontabilitet, ndërsa sipas akt emërimit të datës 01.08.2024 vazhdon në pozitën Zyrtare e Lartë për Financa të gjithë përvojën në Komunën e Vushtrrisë, rrjedhimisht nga provat materiale konstatohet se kandidatja fituese ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit.

Përkitazi me këtë Kolegji i Këshillit, konstaton se Njoftimi me numër protokolli 35741/25, i datës 24.07.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Komunës së Vushtrrisë, për pozitën “*Udhëheqës i Sektorit të Financave dhe Kontabilitetit*” është në pajtim të plotë me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 11 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. *Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit.* 2. *Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën*

përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemri e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1599/2025, datë 29/10/2025

Avdyl BEKTESHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.D;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.